



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.214

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.1437, datë 29.10.2008

Për përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues, për prezumimin e konformitetit të pajisjeve nën presion 11539

Vendim i KM
nr.1716, datë 3.10.2008

Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit..... 11555

Vendim i KM
nr.1718, datë 24.12.2008

Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar..... 11559

VENDIM
Nr.1437, datë 29.10.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE,
QË KANË KARAKTER REFERUES, PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË
PAJISJEVE NËN PRESION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, pika 19, e 27 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues, për prezumimin e konformitetit të pajisjeve nën presion, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference, për prezumimin e konformitetit të pajisjeve nën presion me kërkesat thelbësore, të përcakturara në vendimin nr.73, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve nën presion”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE, QË KANË KARAKTER REFERUES, PËR
PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE NËN PRESION, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR.73, DATË 28.1.2008

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adoptimit si standard shqiptar SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp, ose me përkthim të
-----	---	---	---

			plotë, Pp)
1.	S SH EN 19:2002 Valvolat industriale-Markimi i valvolave metalike	2004	Pp
2.	S SH EN 287-1:2004 Prova miratuese për saldatorë-Saldimet me shkrirje-pjesa 1: Çeliqet	2007	Fp
	S SH EN 287-1:2004/A2:2006		
	S SH EN 287-1:2004/AC:2004		
3.	S SH EN 334:2005 Regullues të presionit të gazit për presione të hyrjes deri në 100 bar	2007	Fp
4.	S SH EN 378-2:2000 Sistemet ftohëse dhe pompat e nxehtësisë. Kërkesat e sigurisë dhe të mjedisit- pjesa 2: Projektimi, prodhimi, provat, markimi dhe dokumentimi	2004	FP
5.	S SH EN 473:2000 Prova pa shkatërrim – Kualifikimi dhe certifikimi i personelit NDT-Parime të përgjithshme	2002	Pp
	S SH EN 473:2000/A1:2005	2007	Fp
6.	S SH EN 593:2004 Ventilat industriale-Ventilat me flutur metalike	2005	Fp
7.	S SH EN 764-5:2002 Pajisje në presion-pjesa 5:Dokumentet e konformitetit dhe të kontrollit të materialeve metalike	2003	Fp
8.	S SH EN 764-7:2002 Pajisje në presion-pjesa 7: Sistemet e sigurisë për pajisjet në presion rezistente ndaj flakës	2003	Fp
	S SH EN 764-7:2002/AC:2006	2007	
9.	S SH EN 1092-3:2003 Fllanxhat dhe bashkimet e tyre-Fllanxhat rrethore për tubat, rubineteritë dhe aksesorët, me PN të përcaktuara-pjesa 3: Fllanxhat prej bakri të lidhur	2004	Fp
	S SH EN 1092-3:2003/AC:2004	2007	
10.	S SH EN 1057:2006 Bakri dhe lidhjet e bakrit-Tubat prej bakri, të rrumbullakët, pa saldime, për ujë dhe për gaz, për përdorime sanitare dhe për ngrohje	2007	Fp
11.	S SH EN 1092-4:2002 Fllanxhat dhe pjesët që bashkohen me to-Fllanxhat rrethore për tubat, rubineteritë, rekordet dhe aksesorët, me presion nominal me PN të përcaktuar – pjesa 4: Fllanxhat prej lidhjesh të aluminit	2004	Fp

12.	S SH EN 1252-1:1998 Enët kriogjenike –materialet-pjesa 1: Kërkesat e qëndrueshmërisë në temperaturat nën -80°C	2002	Fp
	S SH EN 1252-1:1998/AC:1998	2007	
13.	S SH EN 1252-2:2001 Enët kriogjenike – Materialet – pjesa 2: Kërkesat e qëndrueshmërisë në teperaturat ndërmjet -80°C dhe -10°C	2002	Fp
14.	S SH EN 1349:2000 Ventilat e rregullimit të procesit industrial	2004	Fp
	S SH EN 1349:2000/AC:2001	2007	
15.	S SH EN 1591-1:2001 Fllanxhat dhe pjesët e tyre –Rregullat e llogaritjes së pjesëve bashkuese të fllanxhave rrethore me permistop – pjesa 1: Metoda e llogaritjes	2003	Fp
16.	S SH EN 1626:1999 Enët kriogjenike, valvolat për shërbime kriogjenike	2003	Fp
17.	S SH EN 1653:1997 Bakër dhe lidhje bakri-Pllaka, fletë, dhe disqe për bolierë, enë me presion dhe enë mbajtëse të ujit të nxehët	2000	Fp
	S SH EN 1653:1997/A1:2000	2007	
18.	S SH EN 1759-3:2003 Fllanxhat dhe bashkimet e tyre-Fllanxhat rrethore për tubat, rakorderitë dhe aksesorët, me klasë të përcaktuar – pjesa 3: Fllanxhat prej lidhjesh të bakrit	2004	Fp
	S SH EN 1759-3:2003/AC:2004	2007	
19.	S SH EN 1759-4:2003 Fllanxhat dhe bashkimet e tyre – Fllanxhat rrethore për tubat, rakorderitë dhe aksesorët, me klasë të përcaktuar – pjesa 4: Fllanxhat prej lidhjesh të aluminit	2004	Fp
20.	S SH EN 1797:2001 Enët kriogjenike (tejttohëse) – Përputhshmëria ndërmjet gazit dhe materialit	2004	Fp
21.	S SH EN 1866:2005 Fikëset portative të zjarrit	2006	Fp
22.	S SH EN 1983:2006 Valvola industriale - Valvola me sferë çeliku	2007	Fp
23.	S SH EN 1984:2000 Ventilat industrialë-Valvolat prej çeliku të ventilave	2004	Fp

24.	S SH EN ISO 4126-1:2004 Pajisje mbrojtëse për mbrojtjen kundër presionit të lartë- pjesa 1: Valvolat e sigurisë	2007	Fp
	S SH EN ISO 4126-1:2004/AC:2006	2007	
25.	S SH EN ISO 4126-3:2006 Pajisje mbrojtëse për mbrojtjen kundër presionit të lartë - pjesa 3: Valvolat e sigurisë të kombinuara me me mekanizëm sigurie dhe disk ndërprerës	2007	Fp
26.	S SH EN ISO 4126-4:2004 Pajisje mbrojtëse për mbrojtjen kundër presionit të lartë - pjesa 4: Valvolat e sigurisë me drejtues	2007	Fp
27.	S SH EN ISO 4126-5:2004 Pajisje mbrojtëse për mbrojtjen kundër presionit të lartë -pjesa 5: Valvolat e sigurisë me shkarkim të kontrolluar të presionit	2007	Fp
28.	S SH EN ISO 9606-2:2004 Provat e kualifikimit të saldatorëve –Saldimi me shkrirje – pjesa 2: Alumini dhe lidhjet e aluminit	2007	Fp
29.	S SH EN ISO 9606-3:1999 Prova për miratimin e saldatorëve – Saldimi me shkrirje – pjesa 3: Bakri dhe lidhjet e bakrit	2004	Fp
30.	S SH EN ISO 9606-4:1999 Prova për miratimin e saldatorëve –Saldimi me shkrirje –pjesa 4: Niveli dhe lidhjet e nikelit	2004	Fp
31.	S SH EN ISO 9606-5:2000 Prova për miratimin e saldatorëve – Saldimi me shkrirje – pjesa 5: Titani dhe lidhjet e titanit, zirkoni dhe lidhjet e zirkonit	2004	Fp
32.	S SH EN 10028-1:2000 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion –pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2001	Fp
	S SH EN 10028-1:2000/A1:2002	2007	
33.	S SH EN 10028-2:2003 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 2: Çelique të palidhura dhe çelique të lidhura me veti të specifikuar për temperaturë të lartë	2007	Fp
	S SH EN 10028-2:2003/AC:2005		
34.	S SH EN 10028-3:2003 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 3: Çelique saldueshme me strukturë të imët, të normalizuar	2007	Fp

35.	S SH EN 10028-4:2003 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 4: Çelique me lidhje nikeli me veti të specifikuara për temperaturë të lartë	2007	Fp
	S SH EN 10028-4:2003/AC:2005		
36.	S SH EN 10028-5:2005 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 5: Çelique të saldueshme, me strukturë të imët, të petëzuara temomekanikisht	2007	Fp
37.	S SH EN 10028-6:2003 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 6: Çelique të saldueshme, me strukturë të imët, të kalitur dhe të temperuar	2007	Fp
38.	S SH EN 10028-7:2000 Produkte të sheshta prej çeliku për përdorime në presion, pjesa 7: Çeliquet inoksitabël	2001	Fp
	S SH EN 10028-7:2000/AC:2004	2005	
39.	S SH EN 10204:2004 Produkte metalike-Llojet dhe dokumentet e kontrollit	2005	Fp
40.	S SH EN 10213-2:1995 Kushtet teknike të lëvrimit për derdhjet prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 1: Të përgjithshme	2001	Fp
41.	S SH EN 10213-2:1995 Kushtet teknike të lëvrimit për derdhjet prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 2: Markat e çeliqueve për përdorim në temperaturat e mjediseve dhe në temperatura të larta	2001	Fp
42.	S SH EN 10213-3:1995 Kushtet teknike të lëvrimit për derdhjet prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 3: Markat e çeliqueve për përdorim në temperatura të ulëta	2001	Fp
43.	S SH EN 10213-4:1995 Kushtet teknike të lëvrimit për derdhjet prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 4: Markat e çeliqueve austenit dhe austenit-ferit	2001	Fp
44.	S SH EN 10216-1:2002 Tuba çeliku pa tegel saldimit për përdorime në presion – Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 1: Tubat prej çeliku të palidhur me karakteristika specifike në temperaturën e ambientit	2003	Fp
	EN 10216-1:2002/A1:2004	2007	

45.	S SH EN 10216-2:2002 Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion –Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 2: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të lartë	2003	Fp
	S SH EN 10216-2:2002/A1:2004	2007	
46.	S SH EN 10216-3:2002 Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion –Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 1: Tubat prej çeliku të lidhur me strukturë shumë të imët	2003	Fp
	S SH EN 10216-3:2002/A1:2004	2007	Fp
47.	S SH EN 10216-4:2002 Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion –Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 4: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur me karakteristika specifike në temperaturë të ulët	2003	Fp
	S SH EN 10216-4:2002/A1:2004	2007	
48.	S SH EN 10216-5:2004 Tuba çeliku pa tegel saldimi për përdorime në presion- Kushtet teknike të lëvrimit-pjesa 5: Tubat prej çeliku inoksitabël	2007	Fp
49.	S SH EN 10217-1:2004 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 1: Tubat prej çeliku të palidhur me karakteristika specifike në temperaturën e ambientit	2003	Fp
	S SH EN 10217-1:2002/A1:2005	2007	
50.	S SH EN 10217-2:2002 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 1: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur të salduar me rrymë elektrike me karakteristika specifike në temperaturë të lartë	2003	Fp
	S SH EN 10217-2:2002/A1:2005	2007	
51.	S SH EN 10217-3:2002 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 3: Tubat prej çeliku të lidhur me strukturë shumë të imët	2003	Fp
	S SH EN 10217-3:2002/A1:2005	2007	

52.	S SH EN 10217-4:2002 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 4: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur të salduar me rrymë elektrike me karakteristika të specifikuar në temperaturë të ulët	2003	Fp
	S SH EN 10217-4:2002/A1:2005	2007	
53.	S SH EN 10217-5:2002 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 5: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur të salduar me hark të zhytur, pa fluks, me karakteristika të specifikuar në temperaturë të lartë	2003	Fp
	S SH EN 10217-5:2002/A1:2005	2007	
54.	S SH EN 10217-6:2002 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet e lëvrimit- pjesa 6: Tubat prej çeliku të palidhur dhe të lidhur të salduar me dhe hark të zhytur, pa fluks, me karakteristika të specifikuar në temperaturë të ulët	2003	Fp
	S S SH EN 10217-6:2002/A1:2005	2007	
55.	S SH EN 10217-7:2005 Tuba prej çeliku të salduara për përdorime në presion –Kushtet teknike të lëvrimit-pjesa 7: Tubat prej çeliku të inoksitabël	2007	Fp
56	S SH EN 10222-1:1998 Farkëtimet prej çeliku për përdorime në presion – pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme për stampat e e farkëtimit të hapura	2004	Fp
	S SH EN 10222-1:1998/A1:2002	2007	
57.	S SH EN 10222-2:1999 Derdhje çeliku për përdorime të presion-pjesa 2: Çeliqet ferite dhe martensite me veti të specifikuar në temperatura të larta	2001	Fp
	S SH EN 10222-2:1999/AC:2000	2007	
58.	S SH EN 10222-3:1998 Derdhja e çelikut për përdorime në presion-pjesa 3: Çeliqet me nikel me veti të specifikuar të temperaturës së ulët	2001	Fp
59.	S SH EN 10222-4:1998 Copat e farkëtuara prej çeliku për pajisje nën presion –pjesa 4: Çeliqet e saldueshme me strukturë kokrizore të imët me kufi të lartë qëndrueshmërie	2001	Fp
	S SH EN 10222-4:1998/A1:2001	2007	

60.	S SH EN 10222-5:1999 Derdhje çeliku për përdorime në presion- pjesa 5: Çeliquet indoksitabël martenstik, austentik dhe austentik-feritik	2001	Fp
	S SH EN 10222-5:1999/AC:2000	2007	
61.	S SH EN 10269:1999 Çelique dhe lidhje të nikelit për kapëse me veti specifike e të përmirësuara dhe/ose në temperatura të ulëta	2004	Fp
	S SH EN 10269:1999/A1:2006	2007	FP
	S SH EN 10269:1999/A1:2006/AC:2006		
62.	S SH EN 10272:2000 Shufra prej çeliku inoksitabël, që përdoren për presione	2001	Fp
63.	S SH EN 10273:2001 Shufra prej çeliku të saldueshme të lamunuara në të nxehtë për përdorim në presione me cilësi të specifikuar për temperatrat të larta	2001	Fp
64.	S SH EN 10305-4:2003 Tubat e çelikut për përdorime precise-Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 5: Tubat pa saldim të tërhequr në të ftohtë për sistemet hidraulike dhe paneumatike	2005	Fp
65.	S SH EN 10305-6:2005 Tubat e çelikut për përdorime precise-Kushtet teknike të lëvrimit- pjesa 5: Tubat katror dhe drejtkëndësh të salduar dhe të formuar në të ftohtë	2007	Fp
66.	S SH EN ISO 10931:2005 Sistemet e tubave plastike për përdorim industrial-PVDF-Kushtet specifike për përbërësit dhe sistemin	2007	Fp
67.	S SH EN 12178:2003 Sistemet e ftohjes dhe pompat e nxehtësisë-Dispozitivët e tregimit të nivelit të lëngut-Kërkesat, provat dhe marktimi	2005	Fp
68.	S SH EN 12263:1998 Sistemet e ftohjes dhe pompat e nxehtësisë-Dispozitivët e kyçjes së sigurisë për kufizimin e presionit-Kërkesat dhe provat	2004	Fp
69.	S SH EN 12266-1:2003 Valvolat industriale-Prova e ventileve-pjesa 1: Provat e presionit, procedurat e provës dhe kriteret e pranimi-Kërkesat e detyrueshme	2005	Fp
70.	S SH EN 12284:2003 Sistemet e ftohjes dhe pompat e nxehtësisë-Valvolat-Kërkesat, provat dhe markimi	2005	Fp
71.	S SH EN 12288:2003 Ventilat industriale—Valvolat prej lidhje bakri të ventilave	2005	Fp

72.	S SH EN 12334:2001 Valvolat industriale-Ventilat e kontrollit prej gize	2004	Fp
	S SH EN 12334:2001/A1:2004	2007	
73	S SH EN 12392:2004 Alumini dhe lidhjet e aluminit- Produktet e farkëtuara-Kërkesat veçanta për produktet që do të përdoren për prodhimin e pajisjeve në presion	2004	Fp
74.	S SH EN 12420:1999 Bakër dhe lidhje bakri-Derdhje	2004	Fp
75.	S SH EN 12434:2000 Enë tejftohëse-Markuçë (tuba) fleksibël tejftohës	2004	Fp
	S SH EN 12434:2000/AC:2001	2007	
76.	S SH EN 12451:1999 Bakër dhe lidhje bakri-Tubat e rrubullakët pa tegel saldimi për shkëmbyesat nxehtësisë	2001	Fp
77.	S SH EN 12452:1999 Bakër dhe lidhje bakri-Tubat e rrubullakët pa tegel saldimi për këmbyes nxehtësie	2004	Fp
78.	S SH EN 12516-1:2005 Valvola industriale-Rezistenca mekanike e trupit – pjesa 1: Metoda tabulare e trupit të valvolave prej çeliku	2007	Fp
79.	S SH EN 12516-2:2004 Valvola industriale-Rezistenca mekanike e trupit (skatullës)- pjesa 2: Metoda me llogaritje e trupit të valvolave prej çeliku	2007	Fp
80.	S SH EN 12516-3:2002 Valvo-Rezistenca mekanike e trupit (skatullës) -pjesa 3: Metoda eksperimentale	2007	Fp
	S SH EN 12516-3:2002/AC:2003	2007	
81.	S SH EN 12542:2002 Rezervuarët cilindrikë statikë prej çeliku të salduar, të prodhuar në seri, për gaze të lëngshëm të naftës (GLN), të cilët kanë një volum jo më të madh se 13 m ³ dhe për t'u montuar mbi tokë-Projektimi dhe prodhimi	2003	Fp
	S SH EN 12542:2002/A1:2004	2007	
82.	S SH EN 12735-1:2001 Bakri dhe lidhjet e bakrit-Tubat e rrubullakët prej bakri pa tegel për kondicionim ajri dhe ftohje – pjesa 1: Tubat për sistemet e tubacioneve	2004	Fp
	S SH EN 12735-1:2001/A1:2005	2007	

83.	S SH EN 12735-2:2001	2004	Fp
	Bakri dhe lidhjet e bakrit-Tubat e rrumbulakët prej bakri pa tegel për kondicionim ajri dhe ftohje – pjesa 2: Tubat për pajisjet	2007	
84.	S SH EN 12778:2002	2005	Fp
	Artikuj për gatim- Presioni i pajisjeve të gatimit për përdorim shtëpiak		
85.	S SH EN 12952-1:2001	2004	Fp
	Kaldaja me tuba uji dhe instalimet ndihmëse-pjesa 15: Provat e pranimit		
86.	S SH EN 12952-2:2001	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – Pjesa 2: Materialet për pjesët nën presion të boilerëve /kaldajave dhe aksesorët		
87.	S SH EN 12952-3:2001	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – Pjesa 3: Projektimi dhe kalkulimi i pjesëve nën presion		
88.	S SH EN 12952-5:2001	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 5: Punimi dhe konstruksioni i pjesëve nën presion të boilerit/kaldajës		
89.	S SH EN 12952-6:2002	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 6: Inspektimi gjatë konstruksionit, dokumentimi dhe markimi i pjesëve nën presion të boilerit/kaldajës		
90.	S SH EN 12952-7:2002	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 7: Kërkesat për pajisjen për boilerin/kaldajën		
91.	S SH EN 12952-8:2002	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 8: Kërkesat për sistemet e djegëses për lëndët djegëse të lëngëta dhe të gazta për boilerë/kaldajë		
92.	S SH EN 12952-9:2002	2004	Fp
	Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 9: Kërkesat për sistemet e djegies për lëndë të ngurta pluhur për boilerë/kaldajë		
93.	S SH EN 12952-10:2002	2004	Fp
	Kaldaja me tuba uji dhe instalimet ndihmëse- pjesa 10: Kërkesat për mbrojtjen nga tejkalimi i presionit		
94.	S SH EN 12952-14:2004	2005	Fp
	Kaldaja me tuba uji dhe instalimet ndihmëse- pjesa 14: Kërkesa për sistemet DENOX të gypave të gazit që përdorin amoniak të lëngëzuar nën presion dhe tretësirë uji amoniakor		

95.	S SH EN 12952-16:2002 Boilera me tuba uji dhe instalime ndihmëse – pjesa 16: Kërkesat për skara dhe sistemet e djegies së shtratit të fluidizuar për lëndë djegëse të ngurta për boiler/kaldajë	2005	Fp
96.	S SH EN 12953-1:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 1: Të përgjithshme	2004	Fp
97.	S SH EN 12953-2:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 2: Materialet për pjesët nën presion të boilerëve/kaldajave dhe aksesorëve	2004	Fp
98.	S SH EN 12953-3:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 3: Projektimi dhe kalkulimi për pjesët nën presion	2004	Fp
99.	S SH EN 12953-4:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 4: Punimi dhe konstruksioni i pjesëve nën presion të boilerit/kaldajës	2004	Fp
100.	S SH EN 12953-5:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 5: Inspektimi gjatë konstruksionit, dokumentimit dhe markimit të pjesëve nën presion të boilerit/kaldajës	2004	Fp
101.	S SH EN 12953-6:2002 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 6: Kërkesë për pajisje për boilerin/kaldajën	2004	Fp
102.	S SH EN 12953-7:2002 Boilera/kaldaja me këmishë- pjesa 7: Kërkesat për sistemet e djegies së lëndëve të lëngëta dhe të gazta për kaldaja	2004	Fp
103.	S SH EN 12953-8:2001 Boilera/kaldaja me këmishë-pjesa 8: Kërkesat për sigurimin kundër presionit të tepërt	2004	Fp
104.	S SH EN 12953-12:2002 Kaldajat me tub zjarri- pjesa 12: Kërkesa për sistemet e zgarave të djegies së kaldajave me lëndë djegëse të ngurta	2005	Fp
105.	S SH EN 13121-1:2003 Enët dhe cisternat (GRP) për t'u përdorur mbi tokë- pjesa 1: lëndët e para – Konditat e përcaktimit dhe konditat e pranimit	2005	Fp
106.	S SH EN 13121-2:2003 Enët dhe cisternat (GRP) për t'u përdorur mbi tokë- pjesa 2: Materialet përbërëse – Qëndrueshmëria kimike	2005	Fp
107.	S SH EN 13133:2000 Ngjitja –Miratimi i ngjitësit	2004	Fp
108.	S SH EN 13136:2000	2004	Fp

	Ngjitja-Miratimi i procedurës		
109.	S SH EN 13136:2001 Sistemet e ftohjes dhe pompat e nxehtësisë- Pajisjet e zvogëlimit të presionit dhe tubacionet e lidhura me to – Metodatat për llogaritjen	2004	Fp
110.	S SH EN 13175:2003 Specifikimi dhe provat për ventilat dhe pajisjet e rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN)	2005	Fp
	S SH EN 13175:2003/A1:2005	2007	
	S SH EN 13175:2003/AC:2004		
111.	S SH EN 1348:2001 Bakër dhe aliazhe të bakrit – Tuba të rrumbullakët të pasalduar prej bakri për gazet mjekësore ose vakum	2004	Fp
	S SH EN 13348:2001/A1:2005	2007	
112.	S SH EN 13371:2001 Enët kriogjenike-Rakorderitë për serviset kriogjenike	2003	Fp
113.	S SH EN 13397:2001 Valvolat industriale-Valvolat me diafragmë të bëra nga materiale metalike	2004	Fp
114.	S SH EN 13445-1:2002 Enët nën presion rezistente ndaj zjarrit- pjesa 1: Të përgjithshme	2003	Fp
115.	S SH EN 13445-2:2002 Enët nën presion rezistente ndaj zjarrit –pjesa 2: Materialet	2003	Fp
	S SH EN 13445-2:2002/A2:2006	2008	
116.	S SH EN 13445-3:2002 Enët nën presion rezistente ndaj zjarrit –pjesa 3: Projektimi	2003	Fp
	S SH EN 13445-3:2002/A4:2005	2007	
	S SH EN 13445-3:2002/A5:2005		
	S SH EN 13445-3:2002/A6:2005		
	S SH EN 13445-3:2002/A8:2006		
	S SH EN 13445-3:2002/A11:2006	2008	Fp
117.	S SH EN 13445-4:2002 Enët nën presion rezistente ndaj zjarrit- pjesa 4: Prodhimi (fabrikimi)	2003	Fp
	S SH EN 13445-4:2002/A2:2006	2008	
118.	S SH EN 13445-5:2002 Enët nën presion rezistente ndaj zjarrit-pjesa 5: Kontrolli dhe prova	2003	Fp
	S SH EN 13445-5:2002/A2:2005	2007	

	S SH EN 13445-5:2002/A3:2006	2008	
	S SH EN 13445-5:2002/A5:2006		
	S SH EN 133445-5:2002/A4:2006		
119.	S SH EN 13445-6:2002 Enët në presion rezistente ndaj zjarrit- pjesa 6: Kërkesat për projektimin dhe prodhimin e enëve në presion dhe të pjesëve në presion, të cilat janë përgatitur prej gize sferoidale grafite	2003	Fp
	S SH EN 13445-6:2002/A1:2004	2007	
	S SH EN 13445-6:2002/A2:2006	2008	
120.	S SH EN 13445-8:2003 Enët në presion rezistente ndaj zjarrit- pjesa 8: Kërkesat shtesë për enët në presion prej alumini dhe lidhjeve të tij	2008	Fp
121.	S SH EN 13458-1:2002 Enët kriogjenike- Enët fikse, të izoluara në vakum- pjesa 1: Kërkesat themelore	2003	Fp
122.	S SH EN 13458-2:2002 Enët kriogjenike-Enët fikse, të izoluara në vakum – pjesa 2: Projektimi, fabrikimi, inspektimi dhe prova	2003	Fp
	S SH EN 13458-2:2002/AC:2006	2007	
123.	S SH EN 13458-3:2003 Enë tejftohëse- Enë të izoluara statike me vakum (termos)- pjesa 3: Kërkesat për veprim	2005	Fp
	S SH EN 13458-3:2003/A1:2005	2007	
124.	S SH EN 13480-1:2002 Tubat metalikë për industrinë -pjesa 1: Të përgjithshme	2003	Fp
	S SH EN 13480-1:2002/A1:2005	2007	
125.	S SH EN 13480-2:2002 Tuba metalikë për industrinë - pjesa 2: Materiale	2007	Fp
126.	S SH EN 13480-3:2002 Tuba metalikë për industrinë – pjesa 3: Projektimi dhe llogarija	2003	Fp
	S SH EN 13480-3:2002/A1:2005	2007	
	S SH EN 13480-3:2002/A2:2006	2008	
127.	S SH EN 13480-4:2002 Tuba metalikë për industrinë- pjesa 4: Fabrikimi dhe instalime	2003	Fp
128.	S SH EN 13480-5:2002 Tuba metalikë për industrinë-pjesa 5: Inspektimi dhe prova	2003	Fp

129.	S SH EN 13480-6:2002	2007	Fp
	Tubacione metalike industriale- Kërkesa shitesë për tubacionet nëntokësore	2007	
130.	S SH EN 13648-1:2002	2003	Fp
	Enët kriogjenike-Pajisjet mbrojtëse nga mbipresioni-pjesa 1: Valvolat e sigurisë për servisin kriogjenik		
131.	S SH EN 13648-2:2002	2003	Fp
	Enët kriogjenike-Pajisjet mbrojtëse nga mbipresioni-pjesa 2: Pajisjet e mbrojtjes me disqe të thyeshme për servisin kriogjenik		
132.	S SH EN 13648-3:2002	2003	Fp
	Enët kriogjenike (tejtfohtëse)-Pajisjet mbrojtëse nga mbipresioni-pjesa 3: Përcaktimi i shkarkimit të kërkuar- Kapaciteti dhe dimensionimi		
133.	S SH EN 13709:2002	2005	Fp
	Valvolat industriale-Ventilat me sferë çeliku dhe bllokues të sferës dhe përmbajtje		
134.	S SH EN 13789:2002	2004	Fp
	Valvolat industriale-Valvolat me sferë gize		
135.	S SH EN 13923:2005	2007	Fp
	Enët në presion të përfutuara nga mbështjellje teli FRP-Materialet, mbrojtja, prodhimi dhe provat		
136.	S SH EN 14071:2004	2007	Fp
	Valvola sigurie për rezervuarët e GLN-Pajisjet ndihmëse		
137.	S SH EN 14075:2002	2003	Fp
	Rezervuarë cilindrikë, statikë, prej çeliku të salduar, të prodhuar në seri, me një vëllim më të vogël se 13 m ³ , për vendosjen nëntokësore, që përdoren për depozitimin e gazit të lëngëshëm të naftës (LPG); Projektimi dhe prodhimi		
	SH EN 14075:2002/A1:2004	2007	
138.	S SH EN 14129:2004	2007	Fp
	Valvola sigurie për rezervuarët e GLN-së		
139.	S SH EN 14197-1:2003	2005	Fp
	Enë tejftohëse-Enë të izoluara statike pa vakum – pjesa 1: Kërkesat themelore		
140.	S SH EN 14197-2:2003	2007	Fp
	Enë tejftohëse- Enë të izoluara statike pa vakum-pjesa 2: Projekti, prodhimi, inspektimi dhe prova		
	S SH EN 14197-2:2003/A1:2006		
	S SH EN 14197-2:2003/AC:2006		

141	S SH EN 14197-3:2004 Enë tejftohëse- Enë të izoluar statike pa vakum – pjesa 3: Kërkesat për veprim S SH EN 14197-3:2004/A1:2005 S SH EN 14197-3:2004/AC:2004	2007	Fp
142	S SH EN 14222-4:2004 Kaldajat me tub zjarri prej çeliku inoksitabël	2005	Fp
143	S SH EN 14276-1:2006 Pajisjet nën presion për sistemet ftohëse dhe pompat e nxhtësisë-pjesa 1:Enët- Kërkesa të përgjithshme	2006	Fp
144	S SH EN 14341:2006 Valvola industriale- Valvola kufizuese (kontrolluese) prej çeliku	2007	Fp
145	EN 14359:2006 Akumulatorë idropneumatikë për transmesione pneumatike	2008	Fp
146	S SH EN 14382:2005 Dispozitivët e sigurisë për stacionet dhe instalimet e rregullimit të presionit të gazit- Dispozitivët mbyllës të sigurisë për presion pune deri në 100 bar	2005	Fp
147	S SH EN 14570:2005 Pajisje për rezervuarët e GLN, sipërfaqësorë dhe nëntokësorë S SH EN 14570:2005/A1:2006	2007	Fp
148	S SH EN 14585-1:2006 Tuba metalikë të valëzuar që përdoren nën presion – pjesa 1: Kërkesat	2007	Fp
149	S SH EN ISO 15493:2003 Sistemet e tubacioneve plastike për zbatime industriale-Akrilonitril-butadien-streni (ABS), polivinil kloridi i paplastifikuar (PVC-U) dhe polivinil kloridi i kloruar (PVC-C)- Specifikimet për komponentët dhe sistemin- Seritë metrike	2005	Fp
150	S SH EN ISO 15494:2003 Sistemet e tubacioneve plastike për zbatime industriale –Polibutadien (PB), polietileni (PE) dhe polipropileni (PP)-Specifikimet për komponentët dhe sistemin-Seritë metrike	2005	Fp
151	S SH EN ISO 15613:2004 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike- Miratimi me anë të provës para prodhimit	2007	Fp
152	S SH EN ISO 15614-1:2004 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike- Prova e procedurës së saldimit-pjesa 1: Saldimi me hark dhe me gaz i çeliqueve dhe saldimi me hark i nikelit dhe i lidhjeve	2007	Fp

	të nikelit		
153	S SH EN ISO 15614-2:2005 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike. Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit-pjesa 2: Saldimi me hark i aluminit dhe lidhjeve të aluminit	2007	Fp
154	S SH EN ISO 15614-4:2005 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike. Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit-pjesa 4: Dora e fundit e saldimit për ngritjen e aluminit	2007	Fp
155	S SH EN ISO 15614-5:2004 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike- pjesa 5: Saldimi me hark i titanit, zirkonit dhe lidhjeve të tyre	2007	Fp
156	S SH EN ISO 15614-6:2006 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike-Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit-pjesa 6: Saldimi me gaz dhe hark i bakrit dhe lidhjeve të tij	2007	Fp
157	S SH EN ISO 15614-8:2002 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike-pjesa 8: Saldimi i tubave me bashkimet tubë-pllakë	2004	Fp
158	S SH EN ISO 15614-11:2002 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materialet metalike-pjesa 11: Saldimi me tufë elektronesh dhe rrezesh lazer	2004	Fp
159	S SH EN ISO 15620:2000 Saldimi-saldimi me fërkim i materialeve metalike	2004	Fp
160	S SH EN ISO 16135:2006 Valvola industriale-Valvola me sferë prej materiali termoplastik	2007	Fp
161	S SH EN ISO 16136:2006 Valvola industriale-Valvola flutur prej materiali termoplastik	2007	Fp
162	S SH EN ISO 16137:2008 Valvola industriale- Valvola kufizuese prej materiali termoplastik	2007	Fp
163	S SH EN ISO 16138:2007 Valvola industriale-Valvola me membranë prej materiali termoplastik	2007	Fp
164	S SH EN ISO 16139:2006 Valvola industriale-Valvola me rubinet prej materiali termoplastik	2007	Fp
165	S SH EN ISO 21787:2006 Valvola industriale-Valvola të rrumbullakta prej	2007	Fp

	materiali termoplastik		
--	------------------------	--	--

Shënim.

/A1 ose /A2.... janë amendamente të standardit.

VENDIM
Nr.1716, datë 3.10.2008

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.9824, datë 1.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) menaxhon sistemin e akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit, në sferën e detyrueshme dhe atë vullnetare, në Republikën e Shqipërisë.

2. DPA-ja nuk kryen shërbime këshillimi për organizmat e vlerësimit të konformitetit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit bashkëpunon me ministrinë për përgatitjen e rregullave teknike, për të siguruar respektimin e parimeve të akreditimit.

4. Ministri, që mbulon ekonominë dhe tregtinë, miraton rregulloren e brendshme të DPA-së.

5. Pranë DPA-së krijohet bordi këshillimor i akreditimit, i cili mbështet DPA-në për realizimin e detyrave. Numri i anëtarëve të bordit është 16 vetë. Përfaqësimi i anëtarëve të bordit është i balancuar dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. 6 përfaqësues të bordit zgjidhen nga ministrinë përgjegjëse për ekonominë e tregtinë, bujqësinë e ushqimin, çështjet e mjedisit, ndërtimin e transportin, sigurinë e shëndetit dhe të jetës në punë. 2 përfaqësues zgjidhen nga shoqatat profesionale të laboratorëve testues dhe kalibruer, 1 përfaqësues i standardeve, 1 përfaqësues nga organizimi i metrologjisë, 2 përfaqësues nga organizatat e biznesit, 2 përfaqësues nga shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve, 2 përfaqësues nga institucionet shkencore.

Rregullorja e funksionimit të bordit këshillimor të akreditimit, kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit dhe miratimi i tyre për një periudhë trivjeçare miratohen nga ministri, që mbulon ekonominë dhe tregtinë.

6. Anëtarët e bordit shpërblehen me 5000 lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje. Bordi mbledhet një herë në tre muaj.

7. Për nevojat e DPA-së krijohen komitete teknike, *ad-hoc* ose të përhershme, të përbëra nga specialistë të fushave të caktuara, të cilët hartojnë kërkesat e veçanta për akreditimin në fushën përkatëse. Komitetet teknike funksionojnë në bazë të rregulloreve, të miratuara nga drejtori i përgjithshëm.

8. Anëtarët e komiteteve teknike miratohen nga drejtori i përgjithshëm i DPA-së, në bazë të kriterëve të përcaktuara në rregullore. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga Ministri i Financave, me propozimin e ministrit, që mbulon ekonominë dhe tregtinë.

9. Detyrat kryesore të DPA-së janë:

a) Informon ministrinë, që mbulon ekonominë dhe tregtinë, dhe palët e interesuara për veprimtarinë, që kryen në fushën e akreditimit.

b) Informon organizmat e huaj të akreditimit për veprimtarinë në fushën e vlerësimit të konformitetit, për të cilën ka kryer akreditime, dhe për ndryshimet e mundshme.

c) Informon ministrinë, që mbulon ekonominë dhe tregtinë, dhe autoritetet e tjera rregullatore, që kanë lidhje me akreditimin, për qëllimin dhe funksionimin e procesit të vlerësimit të ndërsjellë.

ç) Publikon rezultatet e vlerësimit të ndërsjellë, me fushën e akreditimit, që mbulohet prej saj, dhe ndryshimet e mundshme në to.

d) Informon të gjitha palët e interesuara për parimet, kriteret, procedurat, tarifat e akreditimit dhe organizmat e akredituar në Republikën e Shqipërisë.

dh) Mbron dhe përfaqëson interesat e Republikës së Shqipërisë në organizmat akreditues të huaj dhe organizatat europiane e ndërkombëtare, të cilat trajtojnë kompetencën e organizmave të akreditimit dhe të organizmave të vlerësimit të konformitetit.

10. Ministria, që mbulon ekonominë dhe tregtinë, mbështet DPA-në në anëtarësimin e saj në strukturat e Organizatës Europiane për Akreditimin (EA) dhe të organizmave ndërkombëtarë të akreditimit.

11. DPA-ja merr pjesë në veprimtarinë e organizatave europiane dhe ndërkombëtare të akreditimit, si dhe në veprimtaritë e organizmave europianë, të organeve të autorizuar.

12. DPA-ja bashkëpunon me institucionet publike dhe subjektet private, vendase ose të huaja, në mbështetje të veprimtarisë së saj.

13. DPA-ja informon EA-në dhe anëtarët e saj për hartimin e legjislacionit të ri, në fushën e akreditimit ose që kanë lidhje me akreditimin, në Shqipëri.

14. DPA-ja informon organet përgjegjëse të dhënies së autorizimit apo regjistrimit për dokumentet më të fundit, të publikuara në nivel europian, që kanë lidhje me akreditimin.

15. DPA-ja, gjatë kryerjes së funksioneve:

a) siguron pavarësinë nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, që ajo vlerëson, nga presionet tregtare dhe që të mos ketë konflikte interesi;

b) dokumenton detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetin e personelit, i cili ndikon në cilësinë e vlerësimit dhe të dëshmisë së kompetencës së organizmave të vlerësimit të konformitetit;

c) ruan objektivitetin, transparencën, paanshmërinë, zbaton procedura jodiskriminuese dhe siguron fshehtësinë e informacionit të marrë;

ç) siguron që çdo vendim për dhënien e akreditimit bëhet nga persona kompetentë, të ndryshëm nga ata, që kanë bërë vlerësimin;

d) identifikon veprimtarinë për vlerësim konformiteti, për të cilën ajo është kompetente për kryerjen e akreditimit;

dh) harton procedurat e nevojshme, për të siguruar një menaxhim të efektshëm dhe kontrole të brendshme;

e) mbledh personel, të mjaftueshëm e të aftë, për plotësimin e detyrave;

ë) përcakton procedurat e nevojshme për të kontrolluar aftësinë dhe rezultatet e punës së personelit të saj.

16. Nëse DPA-ja plotëson kërkesat e standardit SSH EN ISOP/IEC 17011, prezumohen të plotësuara kërkesat e mësipërme.

17. Ministria njeh misionin dhe sistemin e vlerësimit të ndërsjellë të EA-së, dhe e pranon si të barasvlefshëm vlerësimin e kryer nga EA-ja me vlerësimin e vet.

18. DPA-ja mirëmban një sistem të brendshëm të vlerësimit të ndërsjellë, korrekt dhe transparent, i cili i nënshtrohet, në mënyrë të rregullt, vlerësimit të ndërsjellë nga EA-ja.

19. DPA-ja akrediton subjektet juridike të interesuara, private dhe publike, vendase apo të huaja.

20. Subjekte juridike që mund të akreditohen janë:

a) Organizmat e vlerësimit të konformitetit, që janë të pavarur ose në varësi të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, që e kanë selinë në Shqipëri.

b) Organizmat shqiptarë, publikë të vlerësimit të konformitetit.

c) Organizmat e vlerësimit të konformitetit, që varen nga organizma të regjistruar jashtë, të cilët kanë seli zyrtare të tyre në Shqipëri e që janë regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë.

ç) Organizmat e huaj të vlerësimit të konformitetit, të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

21. Një organizëm vlerësimi konformiteti vendas mund të kërkojë akreditim nga një organizëm akreditues i huaj vetëm nëse:

a) DPA-ja nuk ofron akreditim për fushën, ku organizmi i vlerësimit të konformitetit dëshiron të akreditohet.

b) DPA-ja nuk ka kryer vlerësim të ndërsjellë ose nuk ka nënshkruar marrëveshje të njohjes së ndërsjellë, në fushën ku organizmi i vlerësimit të konformitetit kërkon të akreditohet.

c) Organizmi i vlerësimit të konformitetit, për arsye biznesi apo tregtare, parapëlqen akreditim nga një organizëm tjetër akreditimi.

ç) Një klient i rëndësishëm i organizmit të vlerësimit të konformitetit kërkon akreditim nga një organizëm akreditimi, i përcaktuar.

d) Organizmi i vlerësimit të konformitetit është një nga degët e një shoqërie të huaj, e cili dëshiron që të gjitha degët e veta të jenë të akredituara nga i njëjti organizëm akreditues.

22. Organizmat e vlerësimit të konformitetit, të regjistruar në Shqipëri dhe të akredituar nga organizma akreditues të huaj, informojnë DPA-në për statusin e tyre të akreditimit.

23. DPA-ja ka të drejtë të kërkojë nga një organizëm akreditues i huaj të kryejë një pjesë të vlerësimit për të. Në këtë rast ajo ka përgjegjësinë për marrjen e vendimit dhe lëshimin e certifikatës.

24. DPA-ja ka të drejtë të kryejë akreditime të përbashkëta me organizma akreditues të huaj.

25. Akreditimet, e kryera nga organizma akreditues të huaj, njihen për dhënie autorizimi apo regjistrimi, vetëm kur:

a) organizmat akreditues janë nënshkrues të marrëveshjeve shumëpalëshe me organizatat europiane dhe ndërkombëtare të akreditimit, në fushën ku organizmi i vlerësimit të konformitetit kërkon të akreditohet;

b) organizmat akreditues janë nënshkruese të marrëveshjeve dypalëshe me DPA-në, për njohjen e ndërsjellë të akreditimeve;

c) ekuivalenca e procedurave të akreditimit është vlerësuar nga DPA-ja, pavarësisht se organizmi akreditues i huaj nuk është nënshkrues i marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

26. Në rast akreditimi nga një organizëm akreditues i huaj, autoriteti i lëshimit të autorizimit/regjistrimit i kërkon organizmit të vlerësimit të konformitetit të pajiset me dokument njohjeje nga DPA-ja, për certifikatën e akreditimit dhe dokumentet shoqëruese të certifikatës.

27. Organizmat e vlerësimit të konformitetit, të interesuar për akreditim apo për vlerësim të kompetencës së tyre, i drejtohen DPA-së. Në procesin e vlerësimit për akreditim, organizmi i vlerësimit të konformitetit kërkues u përgjigjet kriterëve, ashtu si janë përcaktuar, në veçanti, në standardet dhe udhëzuesit e nxjerrë nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit.

28. Organizmi i vlerësimit të konformitetit, që kërkon të akreditohet për qëllime autorizimi apo regjistrimi, aplikon për akreditim, gjithashtu, në bazë të kriterëve, të përcaktuara në pikën 27 të këtij vendimi, plus rregullave dhe kërkesave të veçanta teknike, që lidhen me dhënien e autorizimit apo të regjistrimit.

29. DPA-ja informon organet përgjegjëse të dhënies së autorizimit apo të regjistrimit, në lidhje me kërkesën për akreditim, edhe vendimet për statusin e akreditimit të organizmave, të cilët kërkojnë të jenë apo janë të autorizuar/regjistruar.

30. Organet përgjegjëse të dhënies së autorizimit apo regjistrimit informojnë DPA-në për autorizimet apo regjistrimet e dhëna, si dhe për fushën e veprimit të tyre.

31. Për vlerësimin e kompetencës teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit, DPA-ja ngarkon një ekip, me specialistë vlerësues, vendas apo të huaj, punonjës ose jo të saj, të cilët veprojnë gjithmonë në emër të këtij institucioni. Pagesa e vlerësuesve vendas, jopunonjës të DPA-së, përcaktohet në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.9824, datë 1.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Pagesa e vlerësuesve të huaj mund të kontraktohet, sipas tarifave të vendit të origjinës, por, gjithmonë, në marrëveshje me organizmin e vlerësimit të konformitetit, që ka aplikuar për akreditim.

32. Akreditimi jepet për një afat kohor katërvjeçar.

33. DPA-ja, gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, mbikëqyr, në mënyrë periodike, statusin e akreditimit. Për organizmat e autorizuar apo të regjistruar, mbikëqyrja e akreditimit nga DPA-ja bashkërenditet me atë të organeve përkatëse përgjegjëse, kur këto kryejnë vlerësimet periodike të statusit të autorizimit apo regjistrimit. Nëse ka informacion se një organizëm i akredituar, i autorizuar/regjistruar ose jo, nuk plotëson më kushtet e akreditimit, mbikëqyrja mund të kryhet në çdo kohë, madje dhe pa lajmërim.

34. Në rast pezullimi të autorizimit/regjistrimit, DPA-ja njoftohet nga organet përkatëse

përgjegjëse për të kryer rivlerësimin e kushteve të akreditimit.

35. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i pikave 5 e 8 të këtij vendimi, do të aplikohen nga data 1 janar 2009 dhe mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

36. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

37. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e pikës 8 të këtij vendimi.

38. Vendimi nr.854, datë 19.12.2002 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1718, datë 24.12.2008

PËR PROCEDURAT E TRANSFORMIMIT TË KLUBEVE SPORTIVE NË SHOQËRI
AKSIONARE DHE PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Klubet sportive, që do të transferohen në shoqëri aksionare, do të funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Procedura e transformimit të tyre fillon me daljen e urdhrin të titullarit të institucionit, në varësi administrative të të cilit është klubi sportiv.

3. Përcaktimi i kapitalit themeltar të këtyre shoqërive, që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv, bëhet në bazë të:

a) bilancit të vitit ushtrimor financiar, pararendës;

b) emrit të klubit, të logos së tij dhe të vlerës, që do të jetë deri në masën 30 për qind të vlerës së kapitalit themeltar. Kjo vlerë përcaktohet nga viti i krijimit të klubit, trofetë e arritura, pjesëmarrja në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Përcaktimi i kapitalit të këtyre shoqërive bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo klubi, me urdhrin të titullarit të tij.

5. Klubi sportiv, i transformuar në shoqëri aksionare, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ish-klubit sportiv, në bazë të bilancit financiar, në çastin e transformimit.

6. Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale rivlerësohet, sipas kriterëve të caktuar në vendimin nr.794, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”.

7. Elementet e pasurisë, pa vlerë përdorimi ose të zhvlerësuar, të trajtohen për t’u nxjerrë jashtë përdorimit ose për ulje vlere, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi. Ulja e vlerës të kryhet nga komisioni i vlerësimit, me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

8. Bilanci i çeljes së shoqërisë aksionare, të krijuar nga transformimi i klubit sportiv është bilanci i reformuar. Ky bilanc verifikohet edhe vërtetohet nga një ekspert kontabël, i autorizuar, i

emëruar nga organi, që ka në varësi këtë klub.

9. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin përkatës për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit e të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe për përcaktimin e mënyrës së vlerësimit të aseteve, logos dhe kapitalit.

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.2.2009
Doli nga shtypi më 19.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë